



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1722 Prot.

Tiranë, më datë 20.12.2021

VENDIM
Nr. 686, datë 20.12.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 20.12.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Gërmimit Arkeologjik i realizuar nga person juridik I licencuar në veprimtari arkeologjike “Abkons” sh.p.k., në kuadër të projektit “Pusi vlerësues Shpirag 5 brenda blloqeve 2-3, Zona D”, Bashkia Dimal”, me aplikues “Abkons” sh.p.k. dhe zhvillues “Shell Upstream Albania” sh.a.;
2. Të ruhen “in situ” strukturat e zbuluara të kishës mesjetare dhe subjekti zhvillues të marrë masa për konsolidimin e tyre. Për strukturat e banesës së periudhës helenistike të realizohet mbulimi i tyre “in situ”;
3. Për pjesën tjetër të punimeve në kuadër të zbatimit të projektit “Pusi vlerësues Shpirag 5 brenda blloqeve 2-3, Zona D”, Bashkia Dimal”, të vijojë monitorimi arkeologjik sipas akt – marrëveshjes përkatëse;
4. Subjekti “Abkons” sh.p.k. të marrë masa për përgatitjen e kartelave të objekteve arkeologjike më përfaqësuese dhe t’i depozitojë ato pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Pasurisë Kulturore për regjistrim;
5. Subjekti “Abkons” sh.p.k. të marrë masa për përmbushjen e detyrimit ligjor në lidhje me publikimin e rezultateve të gërmimit arkeologjik sipas parashikimeve dhe afateve të përcaktuara në Rregulloren e Kriteve të Ushtrimit të Profesionit të Arkeologut, miratuar me Vendim Nr. 2, datë 30.01.2009 të KKA;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi

7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

